

Aneksi 9: Lista e Vendeve të Pranueshme të Origjinës

Vendi i origjinës është vendi në të cilin mallrat kanë pësuar transformimin e tyre përfundimtar ekonomikisht të justifikueshëm. Për këtë arsye, dispozitat e Nenit 24 të Kodit Doganor të BE duhet që të zbatohen rast pas rasti për këto mallra¹.

Të gjitha mallrat e blera për qëllime të skemës së grantit duhet të origjinojnë (të kenë pësuar transformimin e tyre përfundimtar) në vendet e mëposhtme.

1. Vendet Anëtare të BE-së

Austri, Belgjikë, Bullgari, Danimarka, Estoni, Finlanda, Franca, Greqi, Gjermani, Holanda, Hungari, Itali, Letoni, Lituani, Luksemburg, Malta, Mbretëria e Bashkuar, Poloni, Portugali, Qipro, Republika Çeke, Rumani, Spanja, Sllovaki, Slloveni, Suedi

2. Vendet e IPA

Shqipëria, Bosnje Hercegovina, Islanda, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kroacia, Mali i Zi, Serbia, Turqia, përfshirë Kosovën

3. Instrumenti Fqinjësisë dhe Partneritetit

Algjeria, Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Egjipti, Gjeorgjia, Izraeli, Jordania, Libani, Libia, Moldavia, Maroku, Rusia, Territori Pushtuar Palestinez, Tunizia, Ukraina

4. Zona Ekonomike Evropjane

Lihtenshtejni, Norvegjia, Zvicra

Në ofertë furnitori duhet që të deklarojë origjinën e mallrave. Pas dorëzimit të mallrave me faturë furnitori duhet që ti dorëzojë Përfituesit *Certifikatën e Origjinës*.

Certifikata e Origjinës duhet të jetë e lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës së mallrave dhe duhet të jetë në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin përkatës të BE.

Megjithatë, furnizimet mund të vijnë nga çdo vend në rastet kur shuma e furnizimeve që do të blihen është më e vogël se pragu i kërkuar për zbatimin e procedurës së prokurimit konkurrues. Termi "origjinë" përkufizohet në nenin 23 dhe 24 të Rregullores së Këshillit (KEE) Nr. 2913/92¹.

¹ Termi origjinë përkufizohet në marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse (më saktë në marrëveshjet e OBT), të cilat reflektohen në legjislacionin e BE si rregullat mbi origjinën për qëllime doganore (Rregullorja e Këshillit (EEC) Nr. 2913/92 - "Kodi Doganor i BE" dhe dispozitat e tij zbatuese, Rregullorja e Komisionit (EEC) Nr. 2454/93.

